

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8323
E premte, 19 qershor 2026
Çmimi 0.50 €

Mblidhet kryesia
e PDK-së, nisin përgatitjet
për procesin e brendshëm
zgjedhor | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PËRFUNDON NUMËRIMI I VOTAVE, LV-ja SIGURON 53 MANDATE, PDK-ja 22, LDK-ja 18 DHE AAK-ja 7

FAQE 4-5



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka përmbyllur numërimin e votave të zgjedhjeve parlamentare të 7 qershorit. Sipas të dhënave të KQZ-

së, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 53 mandate, Partia Demokratike e Kosovës 22, Lidhja Demokratike e Kosovës 18, ndërsa Aleanca 7 man-

date. Njohësit e politikës vlerësojnë se rezultatet nuk prodhuan shumicë të mjaftueshme për formimin e lehtë të institucioneve

AKTUALE



TRUMPI DHE PEZESHKIANI
NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJEN,
I JAPIN FUND LUFTËS F. 2

HAXHIU: MISIONET
NDËRKOMBËTARE NUK
E MORËN SERIOZISHT ADRESIMIN
E KRIMEVE QË SERBIA
KA KRYER NË KOSOVË F. 6

EKONOMI



SHQIPËRIA, USHQIMET MË TË
SHTRENJTA NË RAJON F. 8

AKB: KUSH DEL KUNDËR
AMERIKËS, DEL KUNDËR
ZHVILLIMIT EKONOMIK
DHE TË ARDHMES
EUROATLANTIKE TË KOSOVËS F. 8

SPORT



FSK-ja DHURON 50 KONTEJNERË
PËR FFK-në, KFOR-i BËN
TRANSPORTIN E TYRE F. 11



**KURTI
FALËNDERON
VOTUESIT:
DO TA NISIM PUNËN
PËR FORMIMIN E
INSTITUCIONEVE
TË REJA F. 3**

**RADHË TË GJATA
DHE FLUTURIME
TË HUMBURA:
BE-ja
PARALAJMËRON
LEHTËSIME
NË KUFIJ
GJATË VERËS F. 4-5**



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI DHE PEZESHKIANI NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJEN, I JAPIN FUND LUFTËS NË IRAN

WASHINGTON, 18 QERSHOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara dhe ai i Iranit e kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi si marrëveshje fillestare për paqe, me synim për t'i dhënë fund konfliktit në Lindjen e Mesme.

Presidenti amerikan Donald Trump e nënshkroi memorandumun e mirëkuptimit më 17 qershor gjatë një darke nën dritën e qirinje në Pallatin e Versajës, pas samitit të G7-s.

Memorandumi hyn në fuqi menjëherë. Një video e shpërndarë nga Shtëpia e Bardhë dhe presidenti francez Emmanuel Macron në platformën X shfaq Trumpin duke e nënshkruar dokumentin. "Kjo nuk ishte e lehtë", tha Trumpi teksa nënshkruante marrëveshjen, derisa Macroni, si mikpritës i ngjarjes, dhe të ftuarit e tjerë, duartrokitnin. "Kjo marrëveshje hap rrugën për një paqe të qëndrueshme dhe lejon rihapjen e Ngushticës së Hormuzit", tha Macron në X.

Agjencia shtetërore iraniane e lajmeve, IRNA, publikoi fotografi që tregojnë

presidentin iranian Masud Pezeshkian duke e nënshkruar marrëveshjen midis Iranit dhe Shteteve të Bashkuara.

Në fotografi, presidenti iranian shfaq faqet e marrëveshjes para kamerave, ku shihen qartë si firma e tij ashtu edhe ajo e presidentit amerikan. "Kjo marrëveshje hap rrugën për një paqe të qëndrueshme dhe lejon rihapjen e Ngushticës së Hormuzit", tha Macron në X.

Kryeministri i Pakistanit, Shehbaz Sharif, qeveria e të cilit ndihmoi në ndërmjetësimin e marrëveshjes, njoftoi në platformën X se marrëveshja do të hyjë në fuqi menjëherë.

Si masë fillestare për ndërtimin e besimit, Irani do ta rihapë Ngushticën e Hormuzit, ndërsa Uashingtoni do ta heqë bllokadën e vet detare. Sipas marrëveshjes, Irani gjithashtu duhet ta lehtësojë kalimin e sigurt të anijeve tregtare në këtë rrugë jetike ujore pa pagesë për 60 ditë, gjatë bisedimeve për një kornizë afatgjatë detare me Omanin dhe shtetet arabe të Gjirit.

Shtetet e Bashkuara do të



fillojnë menjëherë ta heqin bllokadën e tyre detare dhe do ta bëjnë këtë plotësisht brenda 30 ditësh.

Zyrtarët amerikanë thanë se marrëveshja tashmë po jep fryt. "Për herë të parë në 100 ditë e këtij konflikti, Irani nuk qëllon ndaj asnjë anijeje", tha një zyrtar më 17 qershor. Memorandumi parashikon gjithashtu heqjen e menjëhershme të sanksioneve amerikane ndaj eksporteve të naftës iraniane, duke ofruar lehtësim të madh për ekonominë e vendit.

Për më tepër, Uashingtoni është zotuar ta lehtësojë themelimin e një fondi rindërtimi prej 300 miliardë dollarësh, të mbështetur nga vendet e rajonit, sapo të arrihet një marrëveshje më e gjerë përfundimtare mbi programin bërthamor të Iranit.

Marrëveshja parashikon gjithashtu heqjen përfundimtare të të gjitha sanksioneve primare dhe sekondare amerikane ndaj Iranit si dhe lirin gradual të aseteve të ngrira iraniane, megjithëse zyrtarët theksuan se këto masa do të varen nga përfillja e detyrimeve nga ana e Iranit. "Ajo që ata e pranuan është se nuk do ta marrin

asnjë qindarkë nëse nuk i përmbushin detyrimet", tha një zyrtar.

Rezervat bërthamore

Në qendër të marrëveshjes është angazhimi i Teheranit për t'i holluar rezervat e tij të uraniumit të pasuruar gjatë një periudhe negociuese dymujore. Sipas zyrtarëve amerikanë, materiali mund të reduktohet përmes "hollimit të tij brenda vendit nën mbikëqyrjen e IAEA-së", Agjencisë Bërthamore të Kombeve të Bashkuara.

Irani ka riafirmuar gjithashtu se "nuk do të zotërojë apo zhvillojë armë bërthamore". Zyrtarët amerikanë thanë se inspektorët ndërkombëtarë dhe ekipet teknike amerikane do të luajnë rol kyç në verifikimin e kësaj. "Ne nuk merremi me besim të verbër", tha një zyrtar i lartë.

Marrëveshja e përkohshme synon të krijojë hapësirë për negociata mbi një kuadër më gjithëpërfshirës që do t'i rregullojë aktivitetet bërthamore të Iranit, për të cilat Uashingtoni prej kohësh dyshon se mund të lidhen me zhvillimin e armëve. Tani vëmendja po përqendrohet te bisedimet

teknike në Zvicër këtë fundjavë, ku negociatorët do të përpiqen ta shndërojnë memorandumun në një plan të hollësishëm zbatimi. "Takimi i kësaj fundjave në Zvicër do të jetë mjaft vendimtar", tha zyrtari i lartë amerikan, duke shtuar se çdo dështim i njëres palë për t'i përmbushur pritshmëritë duhet të bëhet i dukshëm "brenda ditësh ose javësh, jo muajsh".

Megjithëse marrëveshja u mirëprit nga shumë njerëz si hap drejt stabilitetit rajonal, ajo ka nxitur kritika nga disa ligjvënës amerikanë.

Senatori republikan Bill Cassidy argumentoi se ambiciet bërthamore të Iranit nuk janë kufizuar mjaftueshëm dhe paralajmëroi se Teherani e ka kuptuar se mund të fitojë ndikim strategjik përmes kërcënimeve ndaj rrugëve detare tregtare.

Ndërkohë, zyrtarët iranianë e paraqitën marrëveshjen si provë se trysnia ushtarake amerikane kishte dështuar.

Udhëheqësi i Hezbollahut, Naim Qassem, e përshëndeti marrëveshjen si "fitore të madhe" për Iranin dhe falënderoi Teheranin që siguroi përfshirjen e Libanit në fushën e armëpushimit.

Luftimet në frontin libanez janë zbutur që nga shpallja e marrëveshjes, megjithëse dhuna sporadike ka vazhduar, përfshirë sulme izraelite në jug të Libanit dhe sulme të raportuara me raketa dhe dronë.

Tregjet financiare reagan pozitivisht ndaj perspektivës së një zgjidhjeje afatgjatë.

Çmimet e naftës vazhduan të bien ndjeshëm më 18 qershor, pasi kishin rënë tashmë dukshëm ndërsa pritshmëritë për një marrëveshje po rriteshin.



USHTRIA UKRAINASE SULMON MOSKËN, ZELENSKY: PO U DOGJ UKRAINA, DO TË DIGJEN EDHE ATA

KIEV, 18 QERSHOR - "Nëse Putini nuk dëshiron ta përfundojë këtë luftë, por kërkon vazhdimin e saj, ne nuk do të qëndrojmë duarkryq, por do të përgjigjemi", deklaroi Volodymyr Zelensky në komentet e tij lidhur me sulmin më të fundit ndaj një rafinerie naftë në Moskë. "Nëse Ukraina digjet, atëherë do të digjet edhe Moska", ishte komenti i tij.

Presidenti ukrainas deklaroi se sulmi me dron i Kievit ndaj rafinerisë së naftës në Moskë

përbën një përgjigje ndaj sulmit të Rusisë kundër Lavrës Kiev-Pechersk, një prej simboleve më të rëndësishme historike dhe fetare të Ukrainës. "Ne ishim në Lavra dhe unë thashë se do të përgatisim një përgjigje dhe ju do ta shihni. Mendoj se po e shihni tani", tha Zelensky, duke këmbëngulur se qëllimi i Ukrainës është t'i japë fund luftës së nisur nga Rusia. "Ne nuk e duam këtë luftë dhe nuk e kemi dashur kurrë. Të gjithë e

dinë këtë. Edhe partnerët tanë e dinë", ishte mesazhi i tij. Zelensky nënvizoi se mbrojtja ajrore e Moskës, e cila konsiderohet më e forta dhe më e sofistikuar në Rusi, nuk arriti ta ndalojë sulmin me dronë të cilin ai e cilësoi "plotësisht të justifikuar". Rafineria e naftës atje është një nga më të mëdhatë në Rusi dhe furnizon rreth 40 % të tregut të karburantit në Moskë si dhe pjesën më të madhe të benzinës së rajonit.



PËRFUNDON NUMËRIMI I VOTAVE, LV-ja SIGURON 53 MANDATE, PDK-ja 22, LDK-ja 18 DHE AAK-ja 7

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka përmbyllur numërimin e votave të zgjedhjeve parlamentare të 7 qershorit. Sipas të dhënave të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 53 mandate, Partia Demokratike e Kosovës 22, Lidhja Demokratike e Kosovës 18, ndërsa Aleanca 7 mandate. Njohësit e politikës vlerësojnë se rezultatet nuk prodhuan shumicë të mjaftueshme për formimin e lehtë të institucioneve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka përmbyllur procesin e numërimit të votave për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë, duke publikuar rezultatet përfundimtare në platformën zyrtare. Sipas të dhënave të procesuara, Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka dalë e para me 47.13 % të votave, e ndjekur nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 19.44 %, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 16.69 % dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me 6.74 %.

Në bazë të këtyre rezultateve, është formuar edhe përbërja e re prej 120 deputetësh në Kuvendin e Kosovës, ku mandatet shpërndahen mes partive fituese dhe komuniteteve joshumicë. Sipas përditësimit të fundit të KQZ-së, LV-ja ka siguruar 53 mandate, PDK-ja 22, LDK-ja 18, ndërsa AAK-ja 7 mandate.

Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV): Albin Kurti, Glauk Konjufca, Albulena Haxhiu, Hekuran Murati, Donika Gërvalla Schëarz, Xhelal Sveçla, Ejup Maqedonci, Avni Dehari, Hajrulla Çeku, Mimoza Kusari Lila, Shqipe Mehmeti Selimi, Andin Hoti, Arben Vitia,

Ilir Kërçeli, Saranda Bogujevci, Osman Musliu, Nezir Kraki, Alban Bajrami, Arton Konushevci, Edona Llallosi, Mefail Bajqinovci, Ardian Gola, Armend Baloku, Armend Muja, Arbëreshë Kryeziu Hyseni, Arbër Rexhaj, Rufki Suma, Fitore Pacolli Dalipi, Blerim Gashi, Artane Rizvanolli Berisha, Adriana Matoshi, Agim Bahtiri, Arjeta Fejza, Taulant Kelmendi, Arbërie Nagavci, Krenare Çerkini, Dimal Basha, Liza Gashi, Labinotë Demi Murtezi, Artan Abrashi, Adnan Rrustemi, Adelina Grainca, Valon Ramadani, Salih Zyba, Enver Haliqi, Fatmire Kollçaku, Valon Hoti, Valon Peci, Drita Pajaziti, Jeton Raka, Sylejman Mehulli, Vigan Qorrolli dhe Fjolla Ujkani.

Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK): Bedri Hamza, Përparim Gruda, Arian Tahiri, Uran Ismaili, Vlora Çitaku, Sala Jashari, Ganimete Musliu, Enver Hoxhaj, Arben Mustafa, Rrahman Rama, Mërgim Lushtaku, Elmi Reçica, Besa Kabashi Ramaj, Jakup Nura, Eman Rrahmani, Altin Krasniqi, Artan Behrami, Fadil Demaku, Blerta Deliu Kodra, Rrustem Mustafa, Eliza Hoxha dhe Ariana Musliu Shoshi.

Deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK): Vjosa Osmani Sadriu, Lumir



Abdixhiku, Doarsa Kica Xhelili, Hykmete Bajrami, Avdullah Hoti, Ukë Rugova, Kujtim Shala, Anton Quni, Lutfi Haziri, Armend Zemaj, Besian Mustafa, Janina Ymeri, Ermal Sadiku, Jehona Lushaku Sadriu, Arben Gashi, Albena Reshitaj, Fadil Hadërgjonaj dhe Paris Guri.

Deputetët e Aleancës: Ardian Gjini, Ramush Haradinaj, Daut Haradinaj, Besnik Tahiri, Time Kadrijaj, Albana Bytyqi dhe Teuta Haxhiu.

Lista Serbe: Zlatan Elek, Igor Simic, Srdjan Popovic, Slavko Simic, Jovana Radosavljevic, Ljiljana Stefanovic, Milan Joksimovic, Branislav Nikolic dhe Tanja Vujovic.

KDTP: Fikrim Daka dhe Fatma Taçi.

Za Slobodu Pravdu i Opstanak: Nenad Rasic.

Koalicioni VAKAT: Rasim Demiri.

IRDK: Elbert Krasniqi.

Nova Demokratska Stranka: Emilija Redzeqi.

SDU: Duda Balje.

PSA: Artan Asllani.

Partia Liberale Egjiptiane: Veton Berisha.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e mbajtur në mënyrë elektronike ka vendosur për t'i rinumëruar fletëvotimet e 185 vendvotimeve të rregullta, të cilat paraprakisht janë numëruar në Qendrat Komunale të Numërimit.

KQZ-ja ka njoftuar se ky numër përbën 7.41 % të vendvotimeve nga gjithsej 2 498 vendvotime të rregullta në të cilat është zhvilluar votimi më 7 qershor 2026.

Njohësit e proceseve politike vlerësojnë se zgjedhjet e fundit nuk prodhuan një shumicë të mjaftueshme për formimin e lehtë të institucioneve. Sipas tyre, votuesit nuk i kanë dhënë

asnjë subjekti politik mundësinë t'i formojë i vetëm institucionet.

Gazetari Adriatik Kelmendi ka theksuar se votuesit në zgjedhjet e 7 qershorit nuk ia kanë deleguar asnjë subjekti politik të drejtën që t'i bëjë institucionet vetë.

Edhe njohësi i proceseve politike në vend, Ismet Kryeziu, ka thënë se fakti që zgjedhjet e fundit në Kosovë nuk prodhuan një shumicë të mjaftueshme për formimin e lehtë të institucioneve.

Sistemi proporcional i përfaqësimit, i kombinuar me vendet e garantuara për komunitetet joshumicë, e bën shumë më të vështirë krijimin e shumicave të mëdha parlamentare që do t'i mundësonin një partie të vetme kontroll të plotë mbi institucionet, ka thënë Kryeziu.

Kurti falënderon votuesit: Do ta nisim punën për formimin e institucioneve të reja



PRISHTINË, 18 QERSHOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, i ka falënderuar qytetarët për besimin e dhënë në zgjedhjet e 7 qershorit pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha votave. Përmes një videomesazhi të publikuar në "Facebook", Kurti shprehu mirënjohjen për mbështetjen që, sipas tij, qytetarët i dhanë Lëvizjes Vetëvendosje brenda dhe në mërgatë. "Dje përfundoi procesi i numërimit të të gjitha votave. Ju falënderoj përzemërsisht për besimin e

dhënë. Kjo fitore e fuqishme vjen si rezultat i mbështetjes së madhe qytetare brenda Republikës dhe në mërgatë, si dhe angazhimit të mijëra qytetarëve vullnetarë, anëtarëve e aktivistëve të Lëvizjes që nuk u ndalën asnjëherë", ka deklaruar Kurti.

Ai theksoi se rezultati i zgjedhjeve tregoi se nuk kishte nevojë për mbajtjen e zgjedhjeve të reja pasi, sipas tij, raporti i forcave politike nuk ka pësuar ndryshime të mëdha. Sipas Kurtit, Vetëvendosja është

rikonfirmuar forca e parë politike në vend me 53 deputetë në Kuvend. "Rezultati i zgjedhjeve të 7 qershorit tregoi që nuk kishim nevojë për zgjedhje të reja, sepse rezultati nuk ka ndryshuar aq shumë. Si LV jemi rikonfirmuar si partia e parë, me 53 deputetë, dhe tash presim certifikimin e rezultatit të zgjedhjeve në mënyrë që të nisim punën në drejtim të formimit të institucioneve të reja, për të vazhduar punët e mira dhe projektet zhvillimore", ka thënë Kurti.



RADHË TË GJATA DHE FLUTURIME TË HUMBURA: BE-ja PARALAJMËRON LEHTËSIMË NË KUFIJ GJATË VERËS

Bruksel, 18 qershor - Admir V. nga Beogradi e vizitoi Finlandën në prill. Ai ndërroi fluturim në Stokholm dhe thotë se, për shkak të sistemit të ri evropian të hyrje-daljeve, për pak sa nuk e humbi fluturimin e radhës, edhe pse kishte tri orë kohë ndërmjet dy fluturimeve. “Qëndron në radhë dhe pret, pret, pret... Oficeri kufitar fillon me pyetje për udhëtimet e mëparshme, përfshirë arsyet pse kam vizituar një apo një shtet tjetër evropian. Pyetjet ishin deri diku edhe të pakëndshme. Megjithatë, kaosi i vërtetë nisi kur ndodhi diçka me pajisjen, e cila papritur pushoi së funksionuari. Pastaj të gjithë udhëtarët u transferuan në të njëjtën radhë pritjeje”, tregon Edmiri në një bisedë për Radion Evropa e Lirë (REL).

Ngjashëm ka kaluar edhe Bojani nga Podgorica. Ai kishte arritur në aeroportin belg Charleroi dhe u përball me një radhë të gjatë njerëzish që prisnin të kalonin përmes sistemit. Por, atë e shpëtoi fakti që po udhëtonte me një foshnje, ndaj kishte përparësi në kalim. Por, as kjo nuk do të thoshte se kaloi pa pritje, pasi numri i atyre që kishin “përparësi” ishte i madh. Të tjerët, të cilët nuk udhëtonin me foshnja, thotë ai, u desh që të prisnin me orë të tëra. Një grup kolegësh nga Kosova

udhëtuan me makinë drejt Greqisë në fund të majit. Ata zgjodhën qëllimisht ditët e punës për hyrje dhe dalje nga vendi, me qëllim që të shmangnin pritjet e mundshme gjatë fundjavës. Ata kishin parë deklaratat e zyrtarëve evropianë se procedura zgjat shumë pak. Megjithatë, thonë ata, procedura zgjati shumë më tepër nga sa kishin pritur. Sipas personave me të cilët bisedoi REL-i, disa udhëtarë u detyruan t’u përgjigjeshin pyetjeve të policëve kufitarë për arsyet e udhëtimeve të mëparshme ose, për shembull, për mungesën e vulave në pasaportë që do të dëshmonin se kishin dalë nga Zona Shengen.

Të tjerë hasën në probleme teknike me skanimin e gjurmëve të gishtërinjve ose me fotografimin e fytyrës. Ata thonë se për çdo automjet priti të paktën 20 minuta. Hana nga Beogradi në qershor arriti me aeroplan në Bergamo të Italisë. Pas mbërritjes, ajo u rreshtua në kolonën për udhëtarët që nuk janë shtetas të vendeve të Bashkimit Evropian. Ajo priti rreth 45 minuta para se të kalonte kontrollin kufitar dhe procedurën e skanimit. Pas kësaj, ajo udhëtoi me tren nga Italia në Zvicër. Kur ua dorëzoi pasaportën zyrtarëve kufitarë

zvicëranë, të dhënat e saj tashmë ishin të regjistruara në sistem. Në ekran u shfaq edhe fotografia e bërë gjatë kontrollit kufitar në Itali, duke treguar se informacionet ishin tashmë të qasshme për autoritetet kompetente.

Këta janë vetëm disa shembuj të përvojave të shtetasve të të ashtuquajturave vende të treta (shtete që nuk janë anëtare të BE-së), të cilët kalojnë nëpër procedurat e Sistemit të Hyrje-Daljeve (EES).

Sistemi u fut në përdorim në tetor të vitit të kaluar, teksa u bë plotësisht operacional më 10 prill të këtij viti.

Çfarë përfshijnë rregullat e reja?

Bëhet fjalë për një sistem të automatizuar që zëvendëson vulosjen manuale të pasaportave të udhëtarëve që hyjnë në zonën Shengen. Sistemi zbatohet për qytetarët që posedojnë pasaporta biometrike, pavarësisht nëse për hyrje në BE u nevojitet vizë apo jo. Ai regjistron të dhëna biometrike, gjurmët e gishtërinjve dhe fotografinë e fytyrës, si dhe të dhëna personale dhe datat e udhëtimit, me qëllim përmirësimin e sigurisë së

kufijve, zbulimin e personave që tejkalojnë kohën e lejuar të qëndrimit dhe parandalimin e keqpërdorimit të identitetit.

Që nga fillimi i zbatimit të këtij sistemi, është krijuar kaos në aeroportet evropiane. Rrjetet sociale janë mbushur me dëshmi për radhë të gjata pritjeje që ndonjëherë kanë rezultuar edhe me humbjen e fluturimeve.

Nga shërbimet kompetente evropiane thonë se EES tashmë po tregon rezultate pozitive. Nga ana tjetër, udhëtarët do të duhet të përshtaten, pasi kjo do të jetë tani pjesë përbërëse e udhëtimit.

Ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës pritet që në vitet e ardhshme ta lehtësojnë procesin. Megjithatë, viti i parë ka shumë gjasa të jetë i vështirë, ndërsa sezoni i verës do të përbëjë një sfidë të veçantë.

Në prill, 600 fluturime të humbura në Bruksel

Vetëm gjatë festave për Pashkë, rreth 600 persona humbën fluturimin në aeroportin e Brukselit. Për këtë arsye, ky aeroport tani këshillon udhëtarëve të mos e respektojnë rregullin e shkuarjes në aeroporte dy orë më herët. “Vërejtëm se vendosja e EES-it

ka çuar në zgjatjen e kohës së pritjes në dy deri në tre orë. Po bashkëpunojmë me Policinë Federale, e cila është përgjegjëse për kontrollet dhe procesin, dhe po bëjmë gjithçka që është në fuqinë tonë për të menaxhuar sa më mirë radhët”, thuhet në përgjigjen për REL-in nga aeroporti Zaventem, që është aeroporti kryesor në Belgjikë.

Situata është edhe më e vështirë në pikat kufitare tokësore. Nga policia greke për REL deklarohet se komplikimet janë normale gjatë futjes së një sistemi të ri. “Si në çdo kalim të madh drejt procedurave të reja të kontrollit kufitar, zbatimi i sistemit mund të ketë fillimisht ndikim në kohën e përpunimit në disa pika kufitare, veçanërisht gjatë periudhave me trafik të shtuar udhëtarësh. Kjo lidhet kryesisht me kërkesat shtesë për verifikim dhe regjistrim biometrik që duhet të kryhen për shtetasit e vendeve të treta gjatë hyrjeve dhe daljeve. Këto procedura janë pjesë përbërëse e sistemit dhe nuk mund të shmangen”, thanë nga Policia greke në një përgjigje dërguar Radios Evropa e Lirë.

A do të jetë më e lehtë gjatë sezonit veror?

Me afrimin e sezonit veror, disa

shtete evropiane po shqyrtojnë mundësinë e një qasjeje më fleksibile sa i përket përpunimit të të dhënave.

Kroacia dhe Greqia, për shkak të afërsisë gjeografike, mbeten destinacionet më tërheqëse për pushimet verore të qytetarëve të rajonit.

Nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kroacisë konfirmojnë se gjatë kulmit të sezonit lejohet një shkallë e caktuar fleksibiliteti. Kjo mund të përfshijë përjashtime të përkohshme nga marrja e të dhënave biometrike, me skanimin e detyrueshëm të dokumentit të udhëtimit dhe regjistrimin e kohës së hyrjes në një shtet anëtar të BE-së. “Ky model mund të zbatohet në një periudhë të kufizuar kohore, maksimumi deri në gjashtë orë në rrethana të jashtëzakonshme që sjellin një trafik aq të dendur sa që koha e pritjes në pikën kufitare bëhet tepër e gjatë. Kjo konkretisht nënkupton krijimin e një dosjeje EES pa marrjen e të dhënave biometrike”, thanë për Radion Evropa e Lirë nga Ministria e Brendshme e Kroacisë.

Pala kroate pret se do të ketë radhë gjatë sezonit veror, por thekson se ato kanë ekzistuar edhe para futjes në përdorim të këtij sistemi. “Përdorimi i sistemit EES mund të shkaktojë

ngadalësim të përkohshëm të trafikut gjatë ngarkesave të pikut në pikat kufitare rrugore, duke qenë se personi duhet të dalë nga automjeti për t’u regjistruar në aspektin biometrik në sistem. Kjo lehtësohet përmes përdorimit të lexuesve manualë të EES-it, ku biometria merret në korsitë e hyrje-daljes para se personi të arrijë në kabinën e kontrollit”, thanë nga Ministria e Brendshme e Kroacisë. Ata shtojnë se në aeroporte, përveç sistemeve statike, përdoren edhe lexues mobilë EES, kioska dhe e-porta (e-gates) kur është e mundur.

Ndërkaq, nga Policia greke konfirmojnë se gjatë kulmit të sezonit të verës do të përpiqen të jenë më fleksibil për të lehtësuar kalimin e kufijve. “Greqia e përdor në mënyrë të përgjegjshme mundësinë e pezullimit të pjesshëm të parashikuar nga korniza përkatëse të BE-së, me qëllim përputhshmërinë e plotë me rregullat, por edhe ofrimin e shërbimit sa më të mirë të mundshëm për udhëtarët”, thanë për REL-in nga Policia e Greqisë.

Një mundësi të tillë e parashikon edhe Komisioni Evropian, institucioni që e ka vendosur sistemin EES. “Pezullimi i mbledhjes së të

dhënave biometrike është i mundur në disa pika kufitare dhe për një periudhë të kufizuar kohore në raste rrethanash të jashtëzakonshme që çojnë në kohë tepër të gjata pritjeje. Kjo mundësi ekziston deri në shtator, duke mbuluar kulmin e sezonit turistik veror”, thanë nga Komisioni Evropian në një përgjigje dërguar Radios Evropa e Lirë.

A janë zgjidhje e-kioskave?

Në aeroportin e Brukselit mendojnë se përdorimi i kioskave të regjistrimit dhe portave elektronike për disa shtetas të vendeve të treta është pjesë kyç e zgjidhjes për uljen e kohës së pritjes, por theksojnë se zbatimi i tyre ende nuk ka filluar.

“Kjo tashmë është miratuar nga ministrat kompetentë belgë dhe zbatimi i shpejtë është thelbësor për uljen e efikasitetit të kohës së pritjes për qytetarët jashtë BE-së”, thuhet në përgjigjen nga aeroporti i Brukselit.

Kufijtë e brendshëm të Zonës Shengen janë në kompetencë të shteteve anëtare. Prandaj, çdo shtet i rregullon individualisht mënyrën se si qytetarët kalojnë kufijtë.

Nga KE-ja konfirmojnë se zbatimi digjital i sistemit EES

duhet ta lehtësojë procesin. “Rrjedhshmëria e kufijve duhet të sigurohet nga shtetet anëtare përmes sigurimit të numrit të duhur të policëve kufitarë dhe zgjidhjeve të automatizuara, siç janë kioskat vetëshërbyese dhe e-portat [e-gates]”, thonë nga KE-ja, duke shtuar se kjo është veçanërisht e rëndësishme në pikat kufitare me qarkullim të madh.

Nga Policia greke konfirmojnë se po punojnë në mënyrë intensive dhe po investojnë në përmirësimin e infrastrukturës që duhet të lehtësojë procesin e hyrjes dhe daljes nga Zona Shengen.

“Autoritetet kompetente ndjekin vazhdimisht zhvillimet operative dhe, kur është e nevojshme, përshtatin planifikimin dhe shpërndarjen e burimeve për t’iu përgjigjur rritjes sezonale të trafikut dhe për t’i minimizuar sa më shumë shqetësimet për udhëtarët”, thuhet në përgjigjen e Policisë greke.

Sukses apo dështim? KE-ja mburret me rezultatet e sistemit EES

Komisioni Evropian këmbëngul se bëhet fjalë për një sistem shumë të suksesshëm, qëllimi kryesor i të cilit është mbrojtja e kufijve evropianë.

“Zona Shengen është destinacioni më i vizituar në botë, me 40 për qind të të gjitha udhëtimeve ndërkombëtare që kalojnë kufijtë e saj të jashtëm. Në shumicën e shteteve anëtare, përpunimi i regjistrimeve të para zgjat mesatarisht pak më shumë se një minutë”, deklaroi zëdhënësi i Komisionit Evropian, Guillaume Mercier.

Megjithatë, në bisedat me më shumë se dhjetë qytetarë nga Ballkani Perëndimor që gjatë periudhës së fundit kanë kaluar përmes sistemit EES, REL nuk gjeti asnjë bashkëbisedues që konfirmoi se e ka përfunduar të gjithë procedurën brenda një minute.

Zyrtarët e Komisionit Evropian theksojnë se, kur të dhënat e udhëtarëve janë tashmë të regjistruara në sistem, hyrjet dhe daljet e radhës duhet të jenë më të shkurtra dhe më efikase.

Megjithatë, edhe pse sistemi EES po paraqet vështirësi për udhëtarët, në muajt e parë ai tashmë ka treguar rezultate për të cilat është vendosur në funksion.

Sipas të dhënave zyrtare të Komisionit Evropian, që nga tetori 2025 janë regjistruar gati 80 milionë hyrje dhe dalje, 35.000 refuzime hyrjeje, ndërsa rreth 900 persona janë identifikuar si kërcënim për sigurinë e Bashkimit Evropian.



RUTTE: KFOR-i NË TË ARDHMEN DO TË KETË DERI NË 3 500 TRUPA

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se në të ardhmen misioni paqeruajtës i aleancës në Kosovë, KFOR, do të ketë deri në 3 500 trupa.

Rutte këtë deklaratë e bëri në një konferencë për medie në Bruksel, pasi u pyet lidhur me njoftimin e disa ditëve më parë se aleanca ushtarake perëndimore synon ta shkurtojë numrin e trupave paqeruajtëse në Kosovë. "Në këtë moment ju e shihni që KFOR-i ka rreth 4 700 ushtarë. Ajo çfarë do të bëjmë është që do të kthehemi në nivelet e para vitit 2023. Sigurisht, varësisht nga rrethanat, do të shihni një KFOR me 3 000 deri në 3 500 trupa. Dhe mendoj se duke pasur për bazë përmirësimin e situatës, KFOR-i do të vazhdojë të jetë i fokusuar në misionin e tij thelbësor", tha Rutte.

Ai tha se ky ndryshim që do të bëhet në NATO vjen pas përmirësimit të situatës së sigurisë në Kosovë, duke e

cilësuar si "lajm të mirë". "Prandaj, NATO-ja në janar i dha fund dislokimit të forcave rezervë në KFOR. Kjo ndodhi dy vjet pas rotacionit të vazhdueshëm. Në të njëjtën kohë, ne vazhdimisht po shikojmë për pozicionimin më të mirë për KFOR-in për të ardhmen", tha shefi i NATO-s.

Më 12 qershor NATO-ja tha se gradualisht, gjatë vitit të ardhshëm, do ta përshtatë forcën për mbështetjen e KFOR-it. "NATO dhe KFOR-i janë të përkushtuar për sigurinë në Kosovë", tha komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë, gjenerali i Forcave Ajrore amerikane, Alexis G. Grynkewich. "Është ky angazhim që ka çuar në rritjen e stabilitetit, teksa organizatat e sigurisë në Kosovë janë bërë më të afta. Kushtet aktuale ofrojnë mundësi për ta optimizuar madhësinë dhe pozicionimin e KFOR-it", shtoi ai. Pas njoftimit të NATO-s, Shtetet e Bashkuara thanë se presin që të ketë ndryshime në kontributin e



tyre në KFOR.

Një zyrtar i Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara (EUCOM) tha për Radion Evropa e Lirë se vendimi bazohet në rishikimin vjetor të bërë nga Komanda Supreme e Forcave Aleate në Evropë (SHAPE), e cila rekomandoi përshtatjen e trupave në terren. "Bazuar në rishikimin më të fundit vjetor të Komandës Supreme të Forcave Aleate në Evropë, NATO-ja do të

optimizojë pozicionimin e Forcës së Kosovës [KFOR]. Si rezultat, Komanda Evropiane e SHBA-së do të bëjë një përshtatje - në fazë dhe të bazuar në vlerësim të rrezikut - të kontributit amerikan në KFOR, në përputhje me këtë rishikim të udhëhequr nga SHAPE", tha zyrtari për REL-in. Ai shtoi se SHBA-ja vazhdon ta konsiderojë misionin një komponent kyç të stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor,

pa dhënë hollësi për natyrën apo përmasën e ndryshimeve të mundshme.

Më 2023, për shkak të tensioneve në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe, NATO kishte dislokuar afër 1 000 trupa shtesë në Kosovë.

Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë është vendosur më 1999 në vend. Nga afër 50 000 trupa sa ishin dislokuar në atë vit, pas përfundimit të luftës, në Kosovë aktualisht janë rreth 4 600 trupa paqeruajtëse të KFOR-it nga 31 vende të botës.

Italia ka numrin më të lartë të trupave, përkatësisht 907, pasuar nga Shtetet e Bashkuara me 590 paqeruajtës dhe Hungaria me 408.

KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe Misionit për Sundim të Ligjit të Bashkimit Evropian, EULEX.

Misioni i NATO-s, po ashtu, ka përgjegjësinë e sigurisë përgjatë kufirit të Kosovës me Serbinë.

HAXHIU: MISIONET NDËRKOMBËTARE NUK E MORËN SERIOZISHT ADRESIMIN E KRIMEVE QË SERBIA KA KRYER NË KOSOVË

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Ushtruesja e detyrës e presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka marrë pjesë të enjten në shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt: "Së bashku për njohje dhe mbështetje".

Në fjalën e saj para pjesëmarrësve të kësaj konference, Haxhiu ka thënë se në Kosovën e pasluftës, shumë gjëra u numëruan: shtëpitë e djegura, masakrat, njerëzit e vrarë, të pagjeturit, dëmet, varret, kolonat e gjata, u numërua ajo që shihej por, sipas saj, ajo që kishte mbetur brenda njeriut, mbeti pa emër dhe pa vend në rrëfimin tonë publik. "Dhuna seksuale gjatë luftës ishte një prej krimeve që u mbajt shumë gjatë në heshtje. U bë strehë për një dhimbje që njeriu e mban me vete, edhe kur mbaron lufta. Për këtë krim, fjala erdh vonë ngase rrethohej me shumë frikë, shumë turp dhe shumë

grykim. Për këtë arsye, sot duhet të flasim me shumë kujdes. Rrëfimi u takon personave të dhunuar gjatë luftës. Ne jemi këtu për ta thënë qartë se Republika e Kosovës, Republika jonë, u ka borxh njohje, drejtësi dhe kujdes shtetëror", u shpreh Haxhiu.

U. d. presidentja Haxhiu tha se ata që e kryen këtë krim dhe urdhëruan duhet të ndëshkohen nga sistemi ynë i drejtësisë e që, sipas saj, është bërë shumë pak në këtë drejtim pas përfundimit të luftës. "Fatkeqësisht, misionet ndërkombëtare që erdhën në Kosovë për këtë qëllim, asnjëherë nuk u morën seriozisht me adresimin e krimeve, që Serbia i ka bërë në vendin tonë. E kam thënë edhe më herët dhe po e përsëris edhe sot: misionet që kishin përgjegjësi të merreshin me krimet e luftës, në fakt, nuk u morën me to. Viteve të fundit ka pasur përparime në këtë drejtim, besoj se për këtë pajtohemi të



gjithë. Por krimet e kryera nga Serbia në Kosovë kanë qenë aq të shumta e aq të rënda, sa edhe hapat e ndërmarrë së fundmi, sado të rëndësishëm, ende duken të pamjaftueshëm", ka theksuar Haxhiu.

Me këtë rast, u. d. Haxhiu u ka bërë thirrje institucioneve të drejtësisë që të ndërmarrin veprime dhe të mos ndalin angazhimin për adresimin e krimeve të luftës. "Tashmë, fatmirësisht, ka edhe dënime ndaj personave që kanë kryer

dhunë seksuale gjatë luftës, siç ka edhe shumë hetime e aktakuza. Me këtë rast, duhet ta falënderoj znj. Feride Rushiti për punën e madhe që ka bërë në këtë drejtim, por edhe të gjitha organizatat që, në fakt, e kanë zëvendësuar shtetin. Sepse është shteti ynë ai që është dashur të merret me këtë çështje që nga përfundimi i luftës. Megjithatë, veprimet që ndërlihen me fuqizimin e institucioneve të drejtësisë, me rritjen e numrit të policëve, me Strategjinë për Drejtësi Tranzicionale, si dhe me gjykimin në mungesë, janë ndërmarrë shumë vonë", u shpreh Haxhiu.

Ajo më tej tha se puna e institucioneve të Republikës së Kosovës do të vazhdojë, sepse krimet e luftës, siç e dimë, as nuk falen, pra nuk amnistohen dhe as nuk parashkruhen. "Ndëshkimi i kriminelëve, përveç tjerash dërgon edhe mesazh të qartë se shkeljet e rënda të drejtave të

njeriut nuk do të mbeten pa ndëshkim. Prandaj edhe është jashtëzakonisht e rëndësishme që të mos ndalet puna dhe angazhimi. Por, edhe me rastin e aktgjyqimeve dënuese për krimet e luftës shtohet edhe besimi në institucione dhe njihet vuajtja e personave të dhunuar gjatë luftës", ka pohuar Haxhiu.

U. d. presidentja Haxhiu tha se shteti nuk mund ta zhbëjë atë që ka ndodhur, por shteti është i pranishëm me mekanizma, me njerëz dhe me institucione që po e bëjnë rrugën më të lehtë për të mbijetuarit dhe të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës. "Unë i bashkohem thirrjes së Komisionit, që të aplikohet për njohje të statusit, sepse kësaj edhe evidentohet një krim i rëndë që ka ndodhur në periudhën e luftës, por edhe shteti tregon kujdes për personat e dhunuar seksualisht gjatë luftës", tha u. d. presidentja Haxhiu.

FSK-ja VIZITON KOMANDËN MBËSHTETËSE TË FARSH-it, NJIHET NGA AFËR ME MISIONIN DHE STRUKTURËN ORGANIZATIVE

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSh), një delegacion i Gardës Kombëtare dhe Komandës së Logjistikës së FSK-së, kryesuar nga zëvendëskomandanti i Komandës së Logjistikës, kolonel Valdet Berisha, realizuan vizitë zyrtare në Komandën Mbështetëse dhe strukturat vartëse të saj në FARSh. Gjatë vizitës delegacioni u prit nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneralbrigade Aleksandër Pando dhe stafi i tij, ku u

zhvilluan takime profesionale të fokusuar në fushën e logjistikës, trajnimeve dhe emergjencave civile.

Delegacioni pati mundësinë të njihet nga afër me misionin, strukturën organizative dhe kapacitetet e Komandës Mbështetëse si dhe t'i vizitojë kapacitetet logjistike dhe ato të emergjencave civile, duke u informuar mbi organizimin, pajisjet dhe procedurat që përdoren në mbështetje të operacioneve ushtarake dhe menaxhimit të situatave emergjente.

Takimet u karakterizuan nga shkëmbimi i përvojave profesionale dhe diskutimet për zgjerimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, me theks të veçantë në logjistikë dhe emergjencat civile, trajnime dhe ngritjen e kapaciteteve operacionale.

Vizita u zhvillua në frymën e partneritetit dhe besimit të ndërsjellë, duke kontribuar në rritjen e ndërveprueshmërisë dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



Mblidhet Kryesia e PDK-së, nisin përgatitjet për procesin e brendshëm zgjedhor

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur mbledhjen e rregullt të kryesisë, ku temë qendrore e diskutimit ishin përgatitjet për procesin e zgjedhjeve të brendshme në të gjitha nivelet e organizimit, nga nëndegët deri te pozita e kryetarit.

Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, theksoi rëndësinë e një procesi korrekt dhe transparent, duke garantuar përmbajtje dhe



standarde të larta demokratike në çdo hap të tij.

Në këtë kuadër u vendos formimi i një grupi punues, i cili do të ketë përgjegjësi për përgatitjen teknike dhe ligjore të këtij procesi zgjedhor.

Ky grup do të kujdeset për orientimin, mbarëvajtjen dhe strategjinë e përgjithshme, duke siguruar që zgjedhjet të zhvillohen në mënyrë të rregullt dhe të drejtë.

Afati i përcaktuar për fillimin e zgjedhjeve të brendshme është muaji shtator, duke i dhënë kohë të mjaftueshme strukturave organizative për përgatitje të plotë dhe gjithëpërfshirëse.

Kryesia e PDK-së riafirmoi përkushtimin e saj për një proces demokratik, të drejtë dhe përfaqësues, në përputhje me standardet dhe traditën politike të PDK-së.


NË TË ARDHMEN A MUND TË JETOJMË ME KANCERIN SI ME DIABETIN? SQARON ONKOLOGU, ILIR KURTISHI

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Zhvillimet e reja në onkologji po ndryshojnë mënyrën se si mjekët e shohin trajtimin e kancerit. Gjithnjë e më shumë po synohet kontrolli afatgjatë i tij, duke u mundësuar pacientëve të jetojnë më gjatë dhe me cilësi më të mirë jete. Këtë e theksoi onkologu dhe drejtori i Klinikës së Onkologjisë, Ilir Kurtishi, në podcastin "Shëndeti në rend të parë", mbështetur nga United Hospital, ku foli për përparimet e fundit në trajtimin e sëmundjeve malinje dhe rolin e terapive moderne. Sipas tij, një nga synimet kryesore të mjekësisë moderne është që disa forma të kancerit të menaxhohen në mënyrë të ngjashme me sëmundjet kronike, si diabeti apo hipertensioni. "Qëllimi është që nëse sëmundja është në stadi të hershme të trajtohet sa më mirë, ndërsa nëse është e avancuar, të

shndërrohet në një lloj sëmundjeje kronike. Njeriu të jetojë me të, me trajtim adekuat dhe me cilësi të mirë jete, njësoj si me diabetin apo tensionin e lartë", tha Kurtishi, transmeton Telegrafi.

Ai shpjegoi se kjo po bëhet e mundur falë terapive të reja të personalizuara, analizave gjenetike të tumorit dhe zhvillimeve në fushën e inteligjencës artificiale të cilat po ndihmojnë mjekët të identifikojnë më saktë karakteristikat e çdo tumori dhe ta zgjedhin trajtimin më efektiv për secilin pacient. "Përmes analizave të veçanta të indit tumoral ose të gjakut, ne mund ta identifikojmë ADN-në e qelizave malinje dhe të përcaktojmë terapi që e targetojnë sëmundjen në mënyrë shumë më të saktë", tha ai.

Kurtishi theksoi se trajtimet moderne nuk bazohen më



vetëm në vendndodhjen e tumorit, por edhe në profilin e tij molekular dhe gjenetik. Kjo qasje po hap mundësi të reja për kontrollimin e sëmundjes për periudha më të gjata kohore.

Sipas onkologut, pikërisht ky është drejtimi ku po ecën mjekësia bashkëkohore: ta kthejë kancerin nga një diagnozë shpesh fatale në një sëmundje që mund të mbahet

nën kontroll për vite me radhë. "Ky është qëllimi i onkologjisë moderne sot - që pacientët të jetojnë më gjatë, me trajtime më të sakta dhe me një jetë sa më cilësore", tha Kurtishi.

PËR RRETH GJASHTË MUAJ JANË REALIZUAR MBI 4 000 LINDJE NË KLINIKËN E GJINEKOLOGJISË

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Klinika e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) mbetet një ndër shtyllat e rëndësishme të sistemit shëndetësor në vend, duke ofruar kujdes të specializuar dhe shërbime gjithëpërfshirëse për gratë dhe të porsalindurit.

Gjatë periudhës janar - 15 qershor 2026 në Klinikën e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës janë realizuar gjithsej 4 423 lindje, prej këtyre 3 090 kanë qenë lindje spontane, ndërsa 1 333 lindje janë kryer me prerje



cezariane.

Në këtë periudhë ekipet profesionale të klinikës kanë

trajtuar me sukses edhe foshnjat e lindura para kohe, ku 318 prej tyre, pas kujdesit intensiv dhe

trajtimin të specializuar, janë liruar në gjendje të mirë shëndetësore për në shtëpi. "Këto rezultate pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të stafit mjekësor dhe infermieror, të përbërë nga mjekë specialistë, infermiere dhe mamitë, të cilët çdo ditë punojnë me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi për të garantuar siguri dhe kujdes cilësor për nënat dhe foshnjat. Klinika e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës ofron një gamë të gjerë shërbimesh, duke filluar nga kontrollat gjinekologjike,

diagnostikimi dhe trajtimi i sëmundjeve të ndryshme, përcjellja e shtatzënisë, lindjet normale dhe operative, deri te kujdesi pas lindjes dhe trajtimi i rasteve më komplekse obstetrike e gjinekologjike. Shëndeti i gruas dhe i të porsalindurit mbetet prioritet i rëndësishëm i sistemit shëndetësor, pasi investimi në këtë fushë është investim i drejtpërdrejtë në mirëqenien e familjes dhe në të ardhmen e shoqërisë sonë", ka njoftuar Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

Oda Amerikane: Ekonomia e së ardhmes kërkon aftësi, inovacion dhe partneritete të forta

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka mbajtur një prezantim nga dr. Perry N. Wood, drejtor ekzekutiv i Autoritetit të të Ardhurave nga Lojërat e Fatit të Qarkut Erie (ECGRA), me temën "Investimi në industrinë e avancuar dhe

sektorin e prodhimit". Diskutimi trajtoi rolin e industrive të avancuara, ekosistemeve të inovacionit, zhvillimit të fuqisë punëtore dhe sipërmarrjes në nxitjen e transformimit ekonomik dhe konkurrueshmërisë afatgjatë. Pjesëmarrësit reflektuan mbi

përparimin e shpejtë të inteligjencës artificiale dhe ndikimin e saj në industri dhe kulturën organizative. U theksua rëndësia e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet industrisë dhe akademisë, ndërtimit të talenteve të gatshme për të ardhmen si dhe

përafrimit të arsimit dhe aftësive me nevojat e tregut të punës në zhvillim.

Sesioni nënvizoi se rritja e qëndrueshme ekonomike varet nga investimet e vazhdueshme në njerëz, inovacion dhe partneritete të forta ndërsektoriale.



SHQIPËRIA, USHQIMET MË TË SHTRENJTA NË RAJON

TIRANË, 18 QERSHOR - Konsumatorët shqiptarë kanë konsumin individual për frymë të fuqisë blerëse sa 48 % e mesatares së Bashkimit Evropian dhe të ardhurat për frymë sa 43 % e mesatares së Bashkimit Evropian.

Për konsumin sipas fuqisë blerëse, Shqipëria renditet e parafundit në Evropë, duke lënë pas Bosnjën, ndërsa për të ardhurat për frymë është në nivele të njëjta me Maqedoninë e Veriut dhe sërish lë pas Bosnjën (të dhënat për Kosovën mungojnë).

Megjithatë, kur vjen puna për çmimet e ushqimeve, shqiptarët po i paguajnë ato gjithnjë e më shtrenjtë në raport me mesataren e Bashkimit Evropian, të matura sipas fuqisë blerëse.

Të dhënat më të fundit të Eurostatit, që pritet të bëhen publike sot, të përpunuara nga Monitor, tregojnë se çmimet e ushqimeve për herë të parë janë rreth 3 % më të shtrenjta se mesatarja e Bashkimit Evropian. Çmimet janë rritur me shpejtësi, nga 85 % e mesatares së BE-së që ishin në 2022-n, në 99.6 % në 2024-n, për të kaluar në 102.9 % në 2025-n.

E thënë më thjesht, një shportë ushqimesh që mesatarisht kushton 100 euro në Bashkimin Evropian, në Shqipëri kushton rreth 103 euro, e matur sipas fuqisë blerëse, ndërkohë që të ardhurat për frymë të shqiptarëve janë më pak se gjysma e mesatares evropiane. Treguesi i Eurostatit nuk mat çmimet në terma nominalë, por indeksin e nivelit të çmimeve sipas barazisë së fuqisë blerëse (Purchasing Power Parities - PPP). Ky tregues krahason sa kushton e njëjta shportë mallrash dhe shërbimesh në vende të

ndryshme, duke eliminuar efektin e kursit të këmbimit dhe diferencave në nivelin e të ardhurave, shkruan Monitor.

Një nivel mbi 100 tregon se çmimet janë më të larta se mesatarja e Bashkimit Evropian, ndërsa një nivel nën 100 tregon se ato janë më të ulëta.

Shqipëria është vendi i vetëm në rajon ku çmimet e ushqimeve kanë kaluar mesataren e BE-së.

Në kontrast, vendet e tjera të rajonit mbeten dukshëm nën mesataren evropiane. Serbia renditet e dyta me një indeks prej 96.6, megjithëse edhe atje çmimet janë rritur gradualisht nga 91.5 në vitin 2022.

Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina kanë nivel pothuajse të njëjtë çmimesh, përkatësisht 84.6 %, ndërsa Maqedonia e Veriut mbetet vendi më i lirë në rajon me 74.3 % të mesatares së BE-së. Të dhënat për Kosovën mungojnë.

Një vit më parë, Shqipëria u barazua me BE-në për indeksin e çmimeve dhe pije joalkoolike, ndërsa këtë vit ia ka tejkaluar vendeve të Evropës vetëm në treguesin e ushqimeve, (që në 2024-n ishte 99.6 %). Duke përfshirë dhe pijet joalkoolike, indeksi në 2025-n është 103.8 %, nga 101, që ishte në 2024-n. Diferenca bëhet edhe më e dukshme kur krahasohet me nivelin e të ardhurave. Ndërsa Shqipëria ka të ardhura për frymë sa 43% e mesatares së Bashkimit Evropian dhe konsum individual sa 48 % e mesatares së BE-së, çmimet e ushqimeve rezultojnë mbi mesataren evropiane.

Kjo nënkupton se familjet shqiptare duhet të shpenzojnë një pjesë shumë më të madhe të buxhetit të tyre për ushqim krahasuar me qytetarët e vendeve më të pasura të

Evropës.

Teksa qeveria shqiptare ka si ambicie që të fusë Shqipërinë në BE sa më shpejt, duket se vendi po afrohet me Evropën në nivel çmimesh shumë më shpejt sesa në nivel të ardhurash. Ky fenomen redukton fuqinë reale blerëse të familjeve dhe është një nga arsytet pse perceptimi i qytetarëve për mirëqenien mbetet dukshëm më negativ sesa sugjerojnë treguesit e rritjes ekonomike.

Ndonëse Shqipëria vijon të jetë ende vendi më bujqësor në Evropë, ku bujqësia sjell rreth 15% të ekonomisë, nga 2% që është mesatarja evropiane, po detyrohemi të konsumojmë produkte të shtrenjta që vijnë nga importi, apo dhe vendase me çmime të larta për shkak të mungesës së konkurrenshëmërisë. Vetëm pak muaj më parë, çmimi i domates në vend kërcëu në 400-600 lekë për kg.

Çmimet aq të shtrenjta sa dhe të huajt ankohen

Shqipëria nuk është e shtrenjtë për ushqime vetëm e matur sipas fuqisë blerëse, por edhe në çmimet direkte, sidomos për produktet në supermarketet. Më herët, Studiuesi Ilir Ciko ka prezantuar disa gjetje paraprake të studimit "Indeksi i Konkurrencës në Treg (MCI) për Ballkanin Perëndimor: 2026. "Për konsumatorin e thjeshtë shqiptar, rezultatet dëshmojnë se produktet që ai blen në markete evropiane në Shqipëri, zhveshur nga efekti i ndryshëm i TVSH-së, kushtojnë mesatarisht 83 % më shumë se saktësisht të njëjtat produkte të shitura saktësisht nga të njëjtat kompani në tregun Evropian, ndërkohë që fuqia blerëse e tij,



është vetëm 41 % e mesatares së BE", thuhej në studim.

Ankesat për çmimet e larta nuk vijnë vetëm nga konsumatorët vendas.

Në forume udhëtimi si Reddit, TripAdvisor dhe grupet e turistëve që vizitojnë Shqipërinë, një nga komentet më të shpeshta është se supermarketet në Shqipëri janë më të shtrenjta sesa prisnin, madje për disa produkte bazë çmimet krahasohen me ato të vendeve të Evropës Perëndimore.

Turistët shpesh vënë në dukje kontrastin mes të ardhurave të ulëta të vendit dhe çmimeve relativisht të larta të ushqimeve në markete.

Në TripAdvisor, në temën "Ku mund të blihi ushqime që nuk janë të shtrenjta?", një vizitor shkruan se supermarketet në Shqipëri janë "shumë të mbivlerësuara" dhe se nuk kishte parë "çmime kaq absurde", sidomos duke e krahasuar vendin me Maqedoninë e Veriut.

Në një tjetër diskutim në

TripAdvisor për Tiranën, përdoruesit thonë se çmimet në zinxhirë supermarketesh janë "shumë të larta" dhe "më të larta se jashtë". Edhe në Reddit, në r/Albania, turistë dhe të huaj që jetojnë përkohësisht në vend ankohen se blerjet bazë në markete apo dyqane të vogla në Durrës u kanë kushtuar më shumë nga sa prisnin.

Në një diskutim të fundit në Reddit, një turist që vizitoi Tiranën u ankua se në supermarketet e mëdha një litër qumësht kushtonte rreth 300 lekë, gjoksi i pulës 1,700 lekë/kg dhe një paketë musli 500 gramë mbi 1,000 lekë, çmime që i konsideroi "çuditërisht të larta" krahasuar me çmimet në restorante dhe bare.

Ndërsa një turist në Durrës raportonte: "Bleva 2 domate, 1 limon dhe 1 mollë për 3 euro", duke thënë se çmimet reale rezultuan shumë më të larta sesa ato që kishte parë në faqet ndërkombëtare të krahasimit të koston së jetesës.

AKB: KUSH DEL KUNDËR AMERIKËS, DEL KUNDËR ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TË ARDHMES EUROATLANTIKE TË KOSOVËS

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) është shprehur kundër qasjes politike që anashkalojnë partneritetin strategjik të Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka theksuar se Kosova është ndërtuar, mbështetur dhe forcuar falë miqësisë dhe përkrahjes së vazhdueshme amerikane. "Prandaj, çdo vendim madhor politik, ekonomik dhe strategjik duhet të ndërtohet në koordinim të ngushtë me aleatin tonë më të rëndësishëm - ShBA-në. AKB vlerëson se asnjë qeveri e ardhshme nuk duhet të formohet duke injoruar



interesat strategjike të shtetit të Kosovës dhe partneritetin e saj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në veçanti,

kundërshtimi i projekteve që lidhen me investimet amerikane dhe sigurinë energjetike, përfshirë projektet e gazit

amerikan, nuk i shërben zhvillimit ekonomik, forcimit të shtetit dhe integritetit euroatlantik të Kosovës", ka thënë Shahini.

Ai ka deklaruar se Kosova mbetet ndër popujt më pro-amerikanë në Evropë dhe ky orientim nuk është vetëm historik dhe emocional, por edhe ekonomik, zhvillimor dhe strategjik. "Ne besojmë se çdo veprim që cenon ose dobëson partneritetin me SHBA-në dëmton interesat afatgjata të Kosovës, pengon tërheqjen e investimeve të huaja dhe ngadalëson proceset integruese euroatlantike. AKB u bënë thirrje të gjitha partive politike që interesin shtetëror ta vendosin

mbi interesat partiake dhe të forcojnë bashkëpunimin me aleatët strategjikë, në veçanti me ShBA-në, si garanci për zhvillimin ekonomik, sigurinë energjetike dhe të ardhmen euroatlantike të Kosovës", ka theksuar ai.

Agim Shahini, kryetari i AKB-së, thotë se kundërshtimi i projekteve amerikane, përfshirë projektin e gazit amerikan, është kundërshtim i zhvillimit të Kosovës. "Investimet amerikane, partneriteti strategjik me ShBA-në, projekti i gazit amerikan dhe mbështetja e saj për sigurinë energjetike janë jetike për të ardhmen ekonomike dhe euroatlantike të vendit tonë", është shprehur Shahini.

NA DUHET NJË HESHTJE QË TË LINDË PYETJE TË TJERA



Nga MICHELA MARZANO

Nuk kemi folur kurrë kaq shumë sa sot. Fjalët janë kudo. Rrëshqasin në ekranet tona, mbushin bisedat, pushtojnë debatet publike, talk-show-t, rrjetet sociale, madje edhe intimitetin e marrëdhënieve. Të gjithë flasim. Të gjithë reagojnë. Të gjithë komentojnë. Por, mes këtij shumimi të vazhdueshëm të gjuhës, duket sikur diçka është prishur: aftësia për të dëgjuar vërtet.

Nuk bëhet fjalë vetëm për një krizë komunikimi. Nuk është pasojë e thjeshtë e përshpejtimit teknologjik. Ka diçka më të thellë. Sepse të dëgjosh dikë nuk do të thotë thjesht të dëgjosh atë që thotë. Nuk mjafton t'i lësh tjetrit kohën për të folur. Dëgjimi autentik përfshin gjithmonë një formë ekspozimi. Do të thotë të pranosh që prania e tjetrit mund të tronditë imazhin që kemi për veten dhe sigurinë tonë. Dhe pikërisht kjo duket se po bëhet gjithnjë e më e vështirë sot.

Jetojmë në një botë që na shtyn vazhdimisht të mbrohemi nga tjetërsia. Kemi nevojë të përcaktojmë shpejt kë kemi përballë: mik apo armik, viktimë apo fajtor, i brishtë apo i privilegjuar, kompetent apo i paditur. Çdo nuancë krijon

shqetësim. Çdo ambivalencë destabilizon. Sepse ambivalenca na detyron të qëndrojmë në pasiguri, ndërsa koha jonë kërkon përgjigje të menjëhershme, identitete të qarta, pozicione të prera.

Por tjetri nuk mund të reduktohet kurrë në kategoritë me të cilat përipiqemi ta përmbajmë. Dhe kjo është arsyeja pse të dëgjosh vërtet është bërë kaq e rrallë. Sepse të dëgjosh do të thotë të pranosh se diçka të shpëton. Se fjalimi i tjetrit hap një çarje brenda nesh. Se na detyron të përballemi me zona të pazgjdhura të ekzistencës sonë. Nuk dëgjon vërtet nëse mbetesh i pandryshuar. Kur një fjalë arrin thellë në ne, diçka lëviz. Ndonjëherë një plagë e vjetër rihapet. Ndonjëherë një dëshirë që kishim mësuar ta heshtnim del sërish në sipërfaqe.

Për këtë arsye shumë njerëz preferojnë të flasim sesa të dëgjojnë: të flasësh të lejon të ruash kontrollin. Të dëgjosh, përkundrazi, të ekspozon.

Ndoshta edhe për këtë arsye po përballemi sot me një paradoks të çuditshëm: marrëdhëniet shumëfishohen, por shpesh mbeten sipërfaqësore; shkëmbejmë vazhdimisht informacione, por përjetojmë gjithnjë e më pak përvojë njerëzore. Përgjigjemi para se të kemi kuptuar. Dhe mbi të gjitha

kemi frikë nga heshtja, e cila, nga vetë natyra e saj, na detyron të përballemi me atë që nuk arrijmë ta kontrollojmë.

Në heshtje dalin në sipërfaqe pyetjet që përipiqemi vazhdimisht t'i mpijmë: kush jam? Çfarë dëshiroj? Pse e kam kaq të vështirë të dua? Pse ndihem vetëm edhe kur jam i rrethuar nga të tjerët?

Çfarë bëjmë për të shmangur mbushjen e çdo boshllëku? Nuk është rastësi që shumë njerëz kanë nevojë të mbushin vazhdimisht çdo hapësirë mendore: muzikë, podkaste, njoftime, seriale televizive, mesazhe, zhurma në sfond. Megjithatë, vetëm duke kaluar përmes kësaj hapësire të brendshme bëhet e mundur të mirëpresim vërtet tjetrin.

Sepse ai që ikën vazhdimisht nga vetja përfundon pashmangshmërisht duke ikur edhe nga tjetri. Tjetri, atëherë, rrezikon të reduktohet në një "funksion": dikush që duhet të na sigurojë, të konfirmojë identitetin tonë, të plotësojë nevojat tona, të pasqyrojë imazhin që duam të kemi për veten. Por kur pushon së përmbushuri këtë funksion, kur bëhet i paqartë, i largët, i pakuptueshëm, i cenueshëm ose thjesht i ndryshëm, lidhja hyn në krizë.

Të mirëpresësh tjetrin do të

thotë, përkundrazi, të pranosh që ai nuk të përket. Do të thotë të kuptosh se do të mbetet gjithmonë një pjesë e tjetrit që do të jetë e huaj për ne. Dhe pikërisht kjo pakapshmëri e bën të mundur takimin.

Sepse një marrëdhënie autentike nuk lind nga shkrirja, por nga aftësia për të qenë në një distancë pa dashur ta fshish atë. Kjo vlen për çdo marrëdhënie njerëzore, por ndoshta edhe më shumë në marrëdhëniet me të rinjtë. Prej vitesh edukatorë, psikologë dhe gazetarë po pyesin veten mbi shqetësimin e adoleshentëve: ankthin, depresionin, çrregullimet e të ushqyerit, vetëlëndimin, izolimin, varësitë.

Kërkohen shpjegime të menjëhershme, shpesh edhe qetësuese: faji i rrjeteve sociale, pandemia, shkolla, familjet. Sigurisht që të gjithë këta faktorë luajnë një rol. Por rreziku është që, në përpjekjen për të shpjeguar shqetësimin, të përfundojmë pa e dëgjuar më.

Ajo që shumë adoleshentë duket se shprehin sot është mbi të gjitha një vështirësi gjithnjë e më e madhe për të gjetur një hapësirë ku mund të ekzistojnë pa u vlerësuar, matur dhe gjykuar vazhdimisht. Ata rriten brenda një shoqërie të fiksuar pas dukjes, efikasitetit dhe suksesit personal. Një shoqëri që kërkon

vazhdimisht të tregohesh, të përkufizohesh, të dish kush je.


Por si mund ta dish kush je kur ende je duke u formuar? Si mund ta përballosh qetësisht brishtësinë në një botë që e shndërron çdo dobësi në dështim?

Ndoshta pikërisht këtu dëgjimi bëhet thelbësor. Sepse shpesh ajo që një person ka nevojë nuk është një përgjigje, por dikush i gatshëm të qëndrojë pranë tij aq gjatë sa të dalë në sipërfaqe diçka e vërtetë. Një hapësirë ku të mos përkthehesh menjëherë në diagnoza, përkufizime apo etiketa.

Një hapësirë ku heshtja të mos perceptohet si dështim i komunikimit, por si vendi i brishtë ku një fjalë mund të lindë më në fund.

Të dëgjosh vërtet dikë do të thotë gjithashtu të pranosh pafuqinë tënde. Të pranosh se nuk do ta kuptosh kurrë plotësisht përvojën e tjetrit. Se do të ekzistojë gjithmonë një zonë errësire, misteri dhe tjetërsie të pakthyeshme.

Por pikërisht aty, në atë hapësirë që i shpëton kontrollit dhe në aftësinë për të qëndruar të pranishëm përballë asaj që nuk mund ta zotërojmë, mund të lindë një marrëdhënie autentike. Na duhet një heshtje që të lindë pyetje të reja. / La Repubblica. – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ronaldo vendos rekord në Botëror

HOUSTON, 18 QERSHOR - Cristiano Ronaldo është bërë lojtari më i moshuar në një ndeshje të Kupës së Botës, duke vendosur një tjetër rekord në karrierën e jashtëzakonshme. Megjithatë, ndeshja nuk ka

përfunduar siç do ta kishte dëshiruar ylli portugez, pasi Portugalia është ndalur në një barazim 1-1 përballë Kongos. 41-vjeçari është dukur i zhgënjyer dhe i irrituar gjatë sfidës, teksa Portugalia, pavarësisht prej

përbërjes së mbushur me yje, nuk ka arritur të merrte më shumë se një pikë ndaj një kundërshtari që po rikthehej në skenën botërore pas 52 vjetësh mungesë. Madje, përmes rrjeteve sociale, Ronaldo ka shprehur

haptas zhgënjimin. "Nuk ishte fillimi që dëshironim, por është ende larg përfundimit. Mbajeni kokën lart dhe përqendrohuni te ndeshja e radhës", ka shkruar Ronaldo në rrjetet sociale.



FSK-ja DHURON 50 KONTEJNERË PËR FFK-në, KFOR-i BËN TRANSPORTIN E TYRE

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka pranuar një donacion të rëndësishëm nga Forca e Sigurisë së Kosovës, në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe FFK-së, që ishte nënshkruar nga presidenti Agim Ademi dhe ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci. Bëhet fjalë për 50

kontejnerë të dhuruar nga FSK-ja të cilët do të shërbejnë për përmirësimin e infrastrukturës sportive dhe krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e futbollit në vend. Transporti dhe bartja e kontejnerëve është realizuar me mbështetjen e KFOR-it, i cili ka siguruar dërgimin e tyre në lokacionet e përcaktuara nga FFK-ja. Këta kontejnerë do të vendosen në Kampin Nacional të FFK-së në Bërnice dhe në disa stadione anembanë Kosovës që aktualisht nuk kanë zhveshtore, duke krijuar kushte më të mira për klubet, futbollistët dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive.

Ky projekt paraqet një shembull konkret të

bashkëpunimit institucional në funksion të zhvillimit të sportit dhe rinisë në Kosovë, duke kontribuar drejtpërdrejt në avancimin e infrastrukturës sportive.

Presidenti Agim Ademi shpreh mirënjohje dhe falënderon Ministrinë e Mbrojtjes për gatishmërinë për ta mbështetur FFK-në, Forcën e Sigurisë së Kosovës për këtë donacion të çmuar, si dhe KFOR-in për mbështetjen logjistike në transportin e kontejnerëve.

Mbështetja e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare mbetet e rëndësishme për realizimin e projekteve që ndikojnë në zhvillimin e futbollit dhe krijimin e kushteve



më të mira për gjeneratat e reja. Përveç këtij bashkëpunimi, FFK-ja po përgatit edhe projekte të reja për ta thëlluar bashkëpunimin me FSK-në, me synimin që të krijohen formate të përbashkëta garash. FSK deri më tash ka qenë e

pranishme në të gjitha manifestimet dhe turnetë prestigjioze, por tash e tutje synohet krijimi i një formati të ri gjithëpërfshirës, që do ta forcojë edhe më tej lidhjen ndërmjet FFK-së dhe institucioneve të sigurisë në vendin tonë.



ELON BERISHA EMËROHET TRAJNER I FERONIKELIT '74

DRENAS, 18 QERSHOR - Trajneri Elon Berisha do ta udhëheqë FC Feronikelin '74 në sezonin 2026/27 të Superligës së Kosovës në futboll.

Skuadra e rikthyer në elitën e futbollit të Kosovës ka zyrtarizuar emërimin e Berishës në krye të shtabit teknik, duke nënshkruar me të një kontratë dyvjeçare.



Te Feronikeli '74 besojnë se nën drejtimin e trajnerit Berisha do të arrijnë të bëjnë paraqitje dinjitoze dhe të ndërtojnë një ekip konkurrues në Superligë. "Klubi ka arritur marrëveshje me trajnerin Berisha për një kontratë dyvjeçare, duke dëshmuar besimin në vizionin e përbashkët dhe projektin tonë

afatgjatë. Me ambicie të qarta dhe një plan të mirëfilltë për të ardhmen, besojmë se ky është një hap i rëndësishëm në ndërtimin e një ekipi konkurrues dhe të qëndrueshëm, që do t'i sjellë suksese FC Feronikelit '74", është thënë në njoftimin e klubit.

Berisha në pozitën e trajnerit

zëvendëson Granit Begollin, i cili ka udhëhequr ekipin drejt vendit të dytë në Ligën e Parë dhe rikthimin në Superligën e Kosovës.

Për Berishën, Feronikeli '74 do të jetë klubi i tretë që do ta drejtojë në elitën e futbollit të Kosovës. Gjatë sezonit të kaluar ai ishte në krye të Prishtinës së Re dhe Malishevës.

ARMEND THAQI RINOVON KONTRATËN ME GJILANIN DERI NË VITIN 2028



GJILAN, 18 QERSHOR - Armend Thaqi do të vazhdojë të jetë pjesë e Gjilanit edhe në vitet e ardhshme. Klubi i Superligës së Kosovës ka njoftuar se mbrojtësi i krahut të djathtë ka rinovuar kontratën deri në verën e vitit 2028.

Lajmi është bërë me dije nga klubi përmes një njoftimi

zyrtar, ku është vlerësuar rëndësia e Thaqit në projektin afatgjatë të skuadrës. "Pas bisedimeve të zhvilluara në frymë të mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë, palët kanë vendosur ta zgjasin kontratën, duke konfirmuar vazhdimësinë e rrugëtimit të përbashkët dhe objektivave sportive të klubit në

vitet e ardhshme. Armend Thaqi do të vazhdojë të jetë pjesë e rëndësishme e projektit të Sport Club Gjilanit, ndërsa klubi shpreh kënaqësinë për arritjen e këtij pajtimi dhe i uron futbollistit suksese të mëtejshme me fanellën kuqebardhë", është thënë në njoftimin e Gjilanit.

Thaqi ishte një nga lojtarët kyç të ekipit gjatë sezonit të fundit, ndërsa mbajti edhe shiritin e kapitenit të skuadra gjilanase. Me rinovimin e kontratës së mbrojtësit 32-vjeçar, Gjilani siguron vazhdimësinë e një prej futbollistëve më me përvojë në ekip dhe një prej liderëve të dhomës së zhveshjes.

Harry Kane barazon rekordin e Gary Lineker në Kupën e Botës

ARLINGTON, 18 QERSHOR - Harry Kane vazhdon të shkruajë historinë me Anglinë. Sulmuesi ka realizuar dy gola në fitoren 4-2 ndaj Kroacisë, duke e

çuar në 10 numrin e golave të shënuara në Kupat e Botës dhe duke barazuar rekordin legjendar të Gary Lineker si golashënuesi më i mirë i Anglisë në historinë e

këtij kompeticioni. Kane, i cili ishte golashënuesi më i mirë në historinë e kombëtares angleze, tani ndan edhe rekordin botëror të Anglisë me Linekerin. Me

ndeshje të tjera përpara në Botërorin 2026, kapiteni i "Tre Luanëve" ka mundësinë ta thyjë këtë rekord dhe të mbetet i vetëm në krye të listës historike.





NJOFTIM PËR KONTRATË

Kontratë Furnizimi Procedurë e hapur

Në përputhje me nenin 10 "Procedura e hapur", të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (1 dhjetor 2024)

I BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS – BQK

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja:
"Furnizim me material shpenzues për procesim te keshit"
II.2 Numërtimi i Prokurimit: "BQK 26 054 121"

III VENDI I REALIZIMIT TË SHËRBIMIT

III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Objekti i BQK-së, rr. "Luan Haradinaj" nr. 2, 10000 Prishtinë

IV KRITERI PËR DHËNIE TË KONTRATËS

IV.1 "Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë" në përputhje me nenin 34 të Rregullës së prokurimit në BQK (për më tepër informata referojuni versionit të zgjeruar të njoftimit për kontratë publikuar në www.bqk-kos.org/shpallje/tenderet

V INFORMATA ADMINISTRATIVE

V.1 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata të tjera administrative:

Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit, data: 29.06.2026 ora 12:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org.

Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë, data: 29.06.2026 ora 12:00.

V.2 Vendi dhe afati i fundit për dorëzimin e tenderëve, data: 01.07.2026, ora 14:00; Adresa: objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. "Garibaldi" nr. 33, Prishtinë;

V.3 Takimi për hapjen e tenderëve, data: 01.07.2026, ora 14:30; vendi: Objekti i BQK-së, Rr. "Luan Haradinaj" nr. 2, Prishtinë.

V.4 Kushti i sigurimit të tenderit: 2,000.00 € (dy/mijë/euro) për periudhë valide prej 90 dite, (dorëzohet me ofertë).

V.5 Kushti i sigurimit të kontratës (do të kërkohet vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.

VI INFORMATA PLOTËSUESE

VI.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë është në dispozicion në ueb-faqen e BQK-së: www.bqk-kos.org

VII ANKESAT

Në përputhje me "Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Dhjetor 2024)", respektivisht sipas Neni 48 "Procedura e ankesës", çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. "Luan Haradinaj" nr.2, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t'u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "B.B.M INVEST" Sh.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811559600 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "B.B.M INVEST" D.O.O. od Djakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811559600 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "B.B.M INVEST" L.L.C. with headquarters Gjakova, has come to the decision to quit its business: 811559600 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Ardita" SH.P.K. Shpall të pavlefshme numrin e certifikatës së biznesit me nr. 810232546 të lëshuar nga ARBK.
- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë Fizioterapi.
- Ndërmarrja e re Deva Uzina e përpunimit të gazrave teknike sh.p.k. Gjakovë shpall të humbur certifikatën e regjistrimit të biznesit me nr. 810812273 të lëshuar nga ARBK.
- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Mazdrek.
- Eljesa Beqiri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.
- Valentina Sulejmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.
- "Flemingo Kosovo" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810126278.
- Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.
- Ensar Muriqi shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Sulejman Vokshi" në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.
- Jusuf Idrizi shpall të pavlefshme 3 dëftesat QK "11 Marsi" Prizren.
- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore "Ukshin Miftari", Skivjan-Gjakovë.
- Anita Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX sh.f.m.u. "Ibrahim Fehmiu" Prizren.
- Çlirim Gjuraraj nga Gërqina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U "7 Shtatori", nga klasa e 6-9.
- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK "11 Marsi" Prizren.
- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. "7 Shtatori" Prishtinë.
- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

